



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivety	14. 08	3	viti god Year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHICK	5646/2023		118



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.861/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.861/2023 të datës 16.06.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_ dhe ankesën me numër A.nr.859/2023 të datës 16.06.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_, të bashkuar sipas Vendimit VK/2023 të datës 26.07.2023 të Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në një ankesë me numër A.nr.861/2023 kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme-Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/l-031 për Procedurën e Përgjithshme administrative, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.08.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.861/2023 e datës 16.06.2023 e ankuesit \_\_\_\_\_ e bashkuar me ankesën A.nr.859/2023 e datës 16.06.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. Mbetet në Fuqi Vendimi me nr.Nr.78/2023 i datës 05.06.2023 dhe vendimi Nr.10/2023 i datës 14.06.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

## A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër referencës RN00011404 nga Ministria e Punëve të Brendshme, i publikuar sipas njoftimit të datës 06.04.2023 dhe afati për aplikim nga data 27.04.2023 deri me datë 06.05.2023, në vendin e lirë të punës Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike në pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik", me datën 05.06.2023 përmes vendimit me numër Nr.78/2023 i është refuzuar aplikacioni me arsyetim se nuk ka ofruar dëshmi përkatëse se ka zotësi të plotë për të vepruar me afat, ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Më datë 16.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4814/2023 të regjistruar me numër A.nr.861/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër Vendimit me numër Nr.78/2023 të datës 05.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me refuzimin e aplikacionit të tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.06.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit Inspektimit/DMZP, ndërsa Këshilli më datë 26.06.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga e njëjta me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Ndërsa ankuesi \_\_\_\_\_ ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër referencës RN00011404 nga Ministria e Punëve të Brendshme, i publikuar sipas njoftimit të datës 06.04.2023 dhe afati për aplikim nga data 27.04.2023 deri me datë 06.05.2023, në vendin e lirë të punës Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike në pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik", me datën 05.06.2023 me numër Nr.71/2023 i është refuzuar aplikacioni me arsyetim se nuk ka ofruar raport mjekësor se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për kryerjen e detyrës dhe dëshmi përkatëse që kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar, ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Ankuesi \_\_\_\_\_ përmes portalit elektronik ka parashtruar ankesë kundër Vendimit me numër Nr.71/2023 të datës 05.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për mos hyrje në listën e ngushtë. Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me datë 14.06.2023 me numër Nr.10/2023 ka nxjerr vendim me të cilin i ka refuzuar si të pabazuar ankesën me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara me konkurs, kopjet e dëshmisë përkatëse që kandidati ka zotësi për të vepruar.

Ankuesi, me datë 16.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4801/2023 të regjistruar me numër A.nr.859/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër Vendimit me numër Nr.10/2023 të datës 14.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.

02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.06.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Këshilli më datë 26.06.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga e njëjta me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Pas vlerësimit të kërkesës së datës 26.07.2023 të kryetarit të Kolegjit të Këshillit për bashkimin e këtyre ankesave si në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ka marrë vendim me numër VK/2023 me datë 26.07.2023 me numër protokolli 5358/2023 me të cilin ka bashkuar ankesat A.nr.861/2023 të datës 16.06.2023 dhe A.nr.859/2023 të datës 16.06.2023 në një ankesë e të cilat ankesa kanë marrë numrin e fundit të ankesës A.nr.861/2023.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 28.07.2023 ka nxjerr Vendim VK/2023 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës A.nr.861/2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:4801/2023 të datës 16.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga [redacted] për [ankesa.kpmschck@rks0gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks0gov.net) i datës 16.06.2023; Vendimin me numër Nr.71/2023 të datës 05.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme; Vendimin me numër 10/2023 të datës 14.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme; Aplikacioni i kandidatit [redacted] i datës 03.05.2023 së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Certifikatën shëdetësore me numër 008368 të lëshuar nga Qendra Diagnostike Terapeutike "Galaxy"; Kërkesë për sqarim mbi dokumentet e kërkuara për konkursin RPC0005030 të dërguar me E-mail të datës 28.04.2023 nga [redacted] për Ankesën e [redacted] drejtuar DZHRI/DMZP i datës 07.06.2023; Ankesën me numër protokolli 951 të datës 07.06.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted] në Divizionin për Zhvillim e Rekrutimit dhe Inspektimit në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Konkursin e datës 06.04.2023 me emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike për pozitën "Zyrtar i misionit diplomatik" nga MPB; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 23.06.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 23.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 26.06.2023; E-mail nga Arkiva MPB për [redacted] i datës 26.06.2023; Ofrim i dëshmimeve me numër protokolli 1025 të datës 26.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër Nr.05/142 të datës 10.05.2023 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Njoftimin e datës 05.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme; Njoftimin e datës 14.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme; Lista e aplikantëve, Lista e kandidatëve në pritje për konkursin me numër reference RN00011404; Lista e kandidatëve të aprovuar dhe lista e kandidatëve të refuzuar për konkursin me numër reference RN00011404; Aplikacioni i kandidatit [redacted] i datës 03.05.2023; Diplomën me numër 3015 të datës 27.12.2013 të [redacted] të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Filozofik me titull Bachelor i Shkencave Politike; Vërtetim i kopjes nga origjinali me LRP.nr.3319/2021;

Diplomën me numër 4261 të datës 17.07.2018 të [redacted] të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti i Filologjisë me titull Bachelor i Gazetarisë; Vërtetim i kopjes nga origjinali me LRP.nr.3321/2021; Diplomën me numër 747 të datës 18.10.2016 të [redacted] të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Filozofik me titull Master i Shkencave Politike; Vulë apostile me numër 9006/17 e datës 16.05.2017; Vërtetim i kopjes nga origjinali me LRP.nr.3320/2021; Diplomën me numër 563/17 të datës 03.02.2021 të [redacted] të lëshuar nga Universiteti i Tetovës-Fakulteti Juridik; Vërtetim i kopjes nga origjinali me LRP.nr.1380/2023; Certifikatë e datës 31.12.2023 e lëshuar nga " IS Institute" për [redacted]; Certifikatë e datës 28.04.2022 e lëshuar nga " IS Institute" për [redacted]; Certifikatë e datës 20.12.2020 e lëshuar nga " IS Institute" për [redacted]; Certifikatë e datës 25.01.2020 e lëshuar nga Kolegji "Tempulli" për [redacted]; Certifikatë e datës 15.11.2019 e lëshuar nga Universiteti i Tetovës për [redacted]; Certifikatë e datës 28.10.2018 e lëshuar nga " UBT" për [redacted]; Certifikatë e datës 24.03.2018 e lëshuar nga "University of Craiova" për [redacted]; Certifikatë e datës 18.11.2017 e lëshuar nga Universiteti i Tetovës për [redacted]; Certifikatë e datës 19.10.2017 e lëshuar nga "USAID" për [redacted]; Certifikatë e datës 16.02.2018 e lëshuar nga " Kolegji AAB" për [redacted]; Certifikatë e datës 27.06.2015 e lëshuar nga " TBU" për [redacted]; Certifikatë e datës 23.10.2021 e lëshuar nga "AAB" për [redacted]; Certifikatë e datës 01.05.2003 e lëshuar nga " IS" për [redacted]; Certifikatë e datës 01.05.2003 e lëshuar nga " IS" për [redacted]; Certifikatë e datës 01.05.2003 e lëshuar nga " IS" për [redacted]; Marrëveshje për angazhim në masen aktive të tregut të punës praktikë në punë me numër protokolli 5670 të datës 02.07.2019 në mes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës dhe [redacted]; Marrëveshje për angazhim në masen aktive të tregut të punës praktikë në punë me numër protokolli 38 të datës 04.01.2019 në mes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës dhe [redacted] Certifikatë e datës 31.07.2011 e lëshuar nga " The University of Prishtina" për [redacted]; Pasyra e llogarisë nga trusti për [redacted] i datës 16.06.2016-25.04.2023; Kontratë pune nga AKR për [redacted] me numër protokolli 23 i datës 16.06.2016; Vërtetim për praktiken e kryer nga MPJ për [redacted] i datës 14.08.2013; Vlerësim nga RTK për [redacted]; Letër Rekomandim për [redacted] 02.05.2023; Letër Rekomandim për [redacted] 02.05.2023; Letërnjoftim i [redacted]; Letër motivuese e [redacted] i datës 03.05.2023; CV-ja e [redacted] Certifikatë mbi dënimet penale e [redacted] e datës 03.05.2023; Certifikatë nga The cambridge school për [redacted] i datës 08.01.2013; Certifikatë nga Elita 21 për [redacted] i datës 03.11.2008; Ankesën me Nr.Prot:4814/2023 të datës 16.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga [redacted] për [ankesa.kpmshck@rks0gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks0gov.net) i datës 16.06.2023; Dëshmit lidhur me ngarkimin e dokumentacionit në SIMBNJ; E-mailin e datës 06.06.2023 nga [redacted] për [redacted]; E-mailin e datës 09.06.2023 nga [redacted] për [redacted] Njoftimin e datës 05.06.2023 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve të cilët vazhdojnë procedurën e mëtutjeshme të rekrutimit për procedurën me numër RN00011404 të lëshuar nga DMZP-MPB; E-mailin e datës 06.06.2023 nga [redacted] për [redacted], E-mailin e datës 06.06.2023 nga [redacted] për [redacted]; E-mailin e datës 09.06.2023 nga [redacted] për [redacted] E-mailin e datës 14.06.2023 nga [redacted] për [redacted] etj.; Vërtetim me Nr.05-711/1-451 të datës 08.06.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Prishtinës për [redacted]; Konkursin e datës 06.04.2023 me emrin e grupit Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike për pozitën " Zyrtar i misionit diplomatik" nga MPB; Dokumentet e ngarkuara në SIMBNJ; Vërtetim me Nr.05-711/1-405 të datës 25.07.2022 të lëshuar nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Prishtinës për [redacted] Njoftimin e datës 14.06.2023 për plotësim ndryshimit të listës së ngushtë pas shqyrtimit të ankesave lidhur me konkursin me numër të procedurës RN00011404 të lëshuar nga DMZP-MPB;

Shkresën e dërguar nga [redacted] për Drejtorin e DMZP-së [redacted] Vendimin me numër protokolli 812 të datës 19.05.2023 lidhur me shtyrjen e afatit për përfundimin e verifikimit paraprak për procedurën e rekrutimit për pozitën e nivelit profesional të lëshuar nga DMZP-MPB; Vendimin me Nr.78/2023 të datës 05.06.2023 të lëshuar nga DMZP/MPB; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 22.06.2023; E-mail nga A.P.SH. për [redacted] i datës 22.06.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 861/2023 të datës 26.06.2023; E-mail nga Arkiva MPB për A.P.SH. i datës 26.06.2023; Ofrimi i dëshmime me numër protokolli 1026 i datës 26.06.2023; Vendimin me Nr.05/142 të datës 10.05.2023 të lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Kosovës; Lista e Aplikantëve, Lista e kandidatëve në pritje për konkursin me numër RN00011404; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe kandidatëve të refuzuar për konkursin me numër RN00011404; Vendim me numër Nr. 78/2023 i datës 05.06.2023; Aplikacion i datës 03.05.2023 i kandidatit [redacted]; Diplomën me numër Nr.7399 të datës 24.11.2016 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Ekonomik për [redacted] Vërtetim me Ref.Nr.12/6404 të datës 02.12.2022 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për [redacted] Certifikatën e datës 02.03.2020 të lëshuar nga "smt" për [redacted] Certifikatë e lëshuar nga "Council of Europe" për [redacted], Certifikatë e muajit Qershor 2018 të lëshuar nga "Friedrich Ebert Stiftung" për [redacted]; Certifikatë e datës 09.11.2017 të lëshuar nga IKAP për [redacted] Certifikatë e datës 06.06.2017 të lëshuar nga "ICHAT" për [redacted], Certifikatë e datës 29.09.2020 të lëshuar nga "hoja" për [redacted]; Diplomë me numër 175/17 të datës 07.09.2017 të lëshuar nga Kolegji "ILIRIA"- Programi për Mardhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci për [redacted] Certifikatë e datës 14.07.2016 të lëshuar nga Universita "LUM" për [redacted]; Certifikatë e datës 03.07.2016 e lëshuar nga "Youth pass" për [redacted]; Certifikatë e datës 12.05.2017; e lëshuar nga "Youth pass" për [redacted] Certifikatë e lëshuar nga "Coke Summership" për [redacted]; Certifikatë e datës 08.12.2014 të lëshuar nga MTI për [redacted]; Vërtetimi i datës 29.01.2018 të lëshuar nga Ministria e Integrimit Evropian për [redacted]; Pasqyra e llogarisë së Trustit të [redacted] e datës 22.01.2014-22.09.2021; Plotësim ndryshimin e kontratës për marrëdhënien e punës nr.01/2022 me numër protokolli 4190 të datës 11.10.2022 për [redacted]; Kontratë për marrëdhënie të punës me numër protokolli 3661 të datës 15.09.2022 për [redacted]; Letër rekomandim e datës 17.01.2018 e lëshuar nga Ministria e Integrimit Evropian për [redacted]; Letër rekomandim i lëshuar nga Kolegji "Iliria" për [redacted]; Vërtetim i datës 03.05.2023 të lëshuar nga "Britanica ELT" për [redacted]; Letër rekomandim i lëshuar nga Kolegji "Iliria" për [redacted], Letër rekomandim i lëshuar nga Kolegji "Iliria" për [redacted]; Certifikatë shëndetësore të datës 28.04.2023 të [redacted]; Certifikatë mbi dënimet penale për [redacted] e datës 28.04.2023; Pasqyra e llogarisë së Trustit të [redacted] e datës 17.01.2010-25.04.2023; Vendim i KPMSCHK me numër VK/2023 me numër protokolli 5358/2023 i datës 26.07.2023; Vendim i KPMSCHK me numër VK/2023 me numër protokolli 5435/2023 i datës 28.07.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa A.nr.861/2023 e datës 16.06.2023 e Ankuesit [redacted] e bashkuar me ankesën A.nr.859/2023 e datës 16.06.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted] është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale kolegji i këshillit konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme më datë 06.04.2023 ka publikuar Njoftimin për Konkursin me numër reference RN00011404 me emrin e grupit Specialist të Përgjithshëm të Shkencave Politike, për pozitën e punës "Zyrtar i Misionit Diplomatik", me afat

të aplikimit nga data 27.04.2023 deri 06.05.2023. Në këtë konkurs kanë aplikuar edhe ankuesit të cilët sipas shkresave të lëndës nuk janë përfshirë në listën e ngushtë.

Ankuesi \_\_\_\_\_ ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër referencës RN00011404 nga Ministria e Punëve të Brendshme, i publikuar sipas njoftimit të datës 06.04.2023 dhe afati për aplikim nga data 27.04.2023 deri me datë 06.05.2023, në vendin e lirë të punës Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike në pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik", me datën 05.06.2023 me numër Nr.71/2023 i është refuzuar aplikacioni me arsyetim se nuk ka ofruar raport mjekësor se kandidati është në gjendje të mirë shëndetësore për kryerjen e detyrës dhe dëshmi përkatëse që kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar, bazuar në kriteret e konkursit.

Ankuesi përmes portalit elektronik ka parashtruar ankesë kundër Vendimit me numër Nr.71/2023 të datës 05.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik për mos përfshirje në listën e ngushtë. Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me datë 14.06.2023 me numër Nr.10/2023 ka nxjerr vendim me të cilin i ka refuzuar si të pabazuar ankesën me arsyetimin se nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara me konkurs, kopjet e dëshmisë përkatëse që kandidati ka zotësi për të vepruar.

Ankuesi, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër Vendimit me numër Nr.10/2023 të datës 14.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë.

Ndërsa në lidhje me ankuesin \_\_\_\_\_ Kolegji i këshillit konstaton se i njëjti ka aplikuar në konkursin e shpallur me numër referencës RN00011404 nga Ministria e Punëve të Brendshme, i publikuar sipas njoftimit të datës 06.04.2023 dhe afati për aplikim nga data 27.04.2023 deri me datë 06.05.2023, në vendin e lirë të punës Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike në pozitën "Zyrtar i Misionit Diplomatik", dhe se përmes vendimit Nr.78/2023 të datës 05.06.2023 i është refuzuar aplikacioni me arsyetim se nuk ka ofruar dëshmi përkatëse se ka zotësi të plotë për të vepruar me afat, ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Më datë 16.06.2023 Ankuesi \_\_\_\_\_ ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4814/2023 të regjistruar me numër A.nr.861/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore kundër Vendimit me numër Nr.78/2023 të datës 05.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me refuzimin e aplikacionit të tij.

Kolegji i këshillit referuar konkursit me numër reference RN00011404 me emrin e grupit Specialist të Përgjithshëm të Shkencave Politike, për pozitën e punës "Zyrtar i Misionit Diplomatik" të datës 06.04.2023, që ndërlihet me dy ankuesit konstaton se në pikën 3 të konkursit si kërkesa të përgjithshme formale kanë qenë: "Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve në Shkenca Politike, Administratë Publike, Politika Sociale, Juridik", ndërsa në pikën 2. Kërkesa të përgjithshme për pranim kanë qenë: "Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, Të ketë zotësi të plotë për të vepruar, të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët, Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse, Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë

*për kryerjen e një vepre penale me dashje, Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji”, ndërsa në pikën 7 të konkursit sa i përket dokumentacionit që kërkohej të dorëzoheshin me rastin e aplikimit parashihej :”Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit, Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkangjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale, Kopjet e dëshmisë së trajnimeve, Kopjet e dëshmisë së njohjes së gjuhës angleze, Njohja e gjuhës angleze dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë, Dëshmi përkatëse nëse kandidati/ja ka zotësi për të vepruar, Dëshmi mjekësore se kandidati/ja është në gjendje të mirë shëndetësore për të kryerjen e detyrës, Certifikatë, vërtetim nga Gjykata ose Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit, Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar të punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk gjendet në kushtet parashikuara në nenin 8 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.6) të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik”.*


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave referuar bazës ligjore si më lartë si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesit nuk kanë ofruar dëshmitë e kërkuara me konkurs ashtu siç parashihej në dispozitat e Ligjit Nr.06/L -114 për Zyrtarët Publik konkretisht nenin 8 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4, ku përcaktohet se: *“1.Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë:”... 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse....”*, dhe bazuar në atë që u tha si më lartë Vendimet me nr.Nr.78/2023 i datës 05.06.2023 dhe vendimi me Nr.10/2023 i datës 14.06.2023 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë të ankuesve janë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L -114 për Zyrtarët Publik, dispozitat e të cilit ligj i potencuam si më lartë.

Andaj, bazuar në faktet e lartë përmendura më sipër, konstatohet se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër Nr.78/2023 i datës 05.06.2023 dhe vendimit me Nr.10/2023 të datës 14.06.2023, ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material duke vepruar kështu në përputhje me nenin 15 paragrafin 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.861/2023

Çlirim Zeka  
  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesve
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.